

  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL,  
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ Datë . . 2025

“PËR

**MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT, NIVELIT MINIMAL DHE MAKSIMAL TË TË  
ARDHURAVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PLOTËSOJNË  
INDIVIDËT/FAMILJET PËR T’U TRAJTUAR ME PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË  
FAMILJEVE QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, , nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 301, datë 15.4.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë sistemin e pikëzimit për subvencionimin e individëve/familjeve që përfitojnë nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë nivelin maksimal të kredisë, sipas strukturës së apartamentit që ato përfitojnë, referuar të dhënave të institucioneve përkatëse, sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Individit/familja paraqet kërkesën për të përfituar (Faza 1) nga ky program përmes portalit qeveritar “e-Albania”, brenda 30 ditëve kalendarike nga njoftimi publik për hapjen e thirrjes, duke zgjedhur shërbimin “Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social.
4. Individët apo familjet që kanë kaluar fazën e parë, brenda 30 ditëve kalendarike duhet të depozitojnë pranë zyrave të Bashkisë Kolonjë, formularin e strehimit të plotësuar elektronikisht në portalin E-Albania, shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar në Aneksin nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Dokumentacion i vlefshëm do të konsiderohen dokumentet që janë lëshuar nga institucionet kompetente jo më herët se 3 (tre) muajt e fundit. Individit/familja që ka paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, ose në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin në fuqi për strehimin social dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, i hiqet e drejta për të përfituar.

6. Ngarkohet kryetari i Bashkisë, për nxjerrjen e akteve të nevojshme në funksion të realizimit të programit “Subvencionimi i interesave të kredisë” dhe qëllimit të këtij vendimi.

7. Ngarkohen, Drejtoria e Shërbimit Social dhe Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe Administrata e Bashkisë Kolonjë

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Konc: Spec E. Xhelollari  
Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P O.Lifo



**KRYETARI  
ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**N/KRYETAR  
PETRO RISTO**



Tabela nr. 1 - Formula e Pikëzimit për programin e strehimit social "Subvencionimi i interesave të kredisë"

| SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT<br>"SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË" |  | Pikët     |
|--|--|-----------|
| <b>1.1</b>   | <b>KUSHTET E STREHIMIT</b>   | <b>25</b> |
| I.   | Nuk disponon banesë në pronësi   | 7         |
| II.  | Banesa në rrezik shembje   | 4         |
| III.   | Banojnë në banesa të mbi populluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi  | 4         |
| IV.  | Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore   | 4         |
| V.   | Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor                             | 3         |
| VI.  | Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike                                 | 3         |
| <b>1.2</b>   | <b>KUSHTET FAMILJARE</b>   | <b>25</b> |
| I.   | Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë; ku përfshihen dhe vajzat nëna  | 5         |
| II.  | Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore | 0         |
| III.   | Familjet me më shumë se katër fëmijë   | 6         |
| IV.  | Familjet e reja, ku moshja e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç                | 7         |
| V.   | Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç   | 7         |
| <b>1.3</b>   | <b>KUSHTET SOCIALE</b>   | <b>25</b> |
| I.   | Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave                                   | 3         |
| II.  | Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 40 vjeç                           | 3         |
| III.   | Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve  | 0         |
| IV.  | Emigrantë i rikthyer, punëtorë emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatë apo personat me mbrojtje plotësuese                                  | 3         |

|            |  |            |
|------------|--|------------|
| v.         | Familjet e punëve të reja të detyrë  | 0          |
| VI.        | Punonjës i repartit të ndërhyrjes së shpejtë FNSH, punonjës i repartit RENEA, punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin | 2          |
| VII.       | Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit  | 3          |
| VIII.      | Anëtar e komunitetit Rom dhe Egjiptian   | 4          |
| IX.        | I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikime vetë Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur   | 3          |
| X.         | Individë që i përket komunitetit LGBTI   | 2          |
| <b>I.4</b> | <b>KUSHTET EKONOMIKE</b>   | <b>25</b>  |
| i.         | Familje me të ardhura mesatare që janë familjet me të ardhura mujore midis 100 dhe 120 për qind e të ardhurave mesatare                    | 10         |
| ii.        | Familje me të ardhura të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore midis 70 dhe 100 për qind e të ardhurave mesatare                    | 9          |
| iii.       | familje me të ardhura shumë të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 70 për qind e të ardhurave mesatare             | 6          |
| iv.        | Familje pa të ardhura  | 0          |
|            | <b>TOTALI PIKË</b>   | <b>100</b> |

**Tabela 2 - Të ardhurat minimum dhe maksimum të përfituesve potencialë sipas tabelës:**

| <b>Struktura familjare</b> | <b>Struktura apartamentit</b> | <b>Sip.Takuese</b> | <b>Vlera maksimale e kredis</b> |
|----------------------------|-------------------------------|--------------------|---------------------------------|
| 1- 2                       | Garsoniere                    | 45                 | 1,125,000                       |
| 3                          | 1+1                           | 55                 | 1,375,000                       |
| 4                          | 2+1                           | 81                 | 2,025,000                       |
| 5 - 6                      | 3+1                           | 100                | 2,500,000                       |

Ju faleminderit!

Konc: Spec E. Xhelollari  
Konfirmoi: Drejtori D.CJ.P.P O.Lifo



**KRYETARI  
ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**N/KRYETAR  
PETRO RISTO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL,  
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. 7133 Prot

Ersekë, më 12.12.2025

RELACION  
PËR

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ Datë . . . 2025

“PËR

**MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT, NIVELIT MINIMAL DHE MAKSIMAL TË TË  
ARDHURAVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PLOTËSOJNË  
INDIVIDËT/FAMILJET PËR T’U TRAJTUAR ME PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË  
FAMILJEVE QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr 22/2018, “Për Strehimin Social”, Neni.15 pika(3) Njësitë e Vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies për trajtimin sipasprogramit të subveconimit të familjeve që përfitojnë kredi të lehtësur nga shteti, Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të paraqesë në Këshjillin Bashkiak për Miratim sistemin e pikëzimit dhe dokumentat e nevojshëm për përfitimin e subveconimit të kredisë nga buxheti i shtetit.

Konc: Spec E. Xhelollari  
Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P O.Lifo

KRYETARI  
ERION ISAI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
N/KRYETAR  
PETRO RISTO

